



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të Nenit 47 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43,14), Nenit 20 paragrafi 3 dhe Nenit 42 paragrafi 2 të Ligjit për Punë Devizore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/01, 49/01, 103/01, 51/03, 81/08, 24/11, 135/11, 188/13 dhe 97/15), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

VENDIM

për mënyrën dhe kushtet për evidentimin dhe depozitimin e raporteve për operacionet kreditore të lidhura

1. Me këtë vendim përcaktohet mënyra e evidentimit të operacioneve kreditore të lidhura me jorezidentët, si dhe afatet dhe kushtet në të cilat rezidentët raportojnë në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore).

2. Rezidentët detyrimisht i raportojnë për evidentim dhe njoftojnë Bankën Popullore për operacionet kreditore të përcaktuara në Nenin 2, paragrafi 16, pikat 3 dhe 4 dhe paragrafët 19, 20 dhe 21 të Ligjit për Punë Devizore.

3. Operacionet kreditore nga pika 2 e këtij vendimi evidentohen individualisht, në bazë të kontratës me shkrim për operacionin kreditor të lidhur me jorezident dhe për ta raportohet individualisht. Banka Popullore i evidenton operacionet kreditore në mënyrë individuale, në përputhje me elementet bazë të operacionit kreditor të përfshira në kontratë, si: shuma, kushtet për dhënien, shfrytëzimin dhe kthimin.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, operacionet kreditore si: dorëzani, garancitë, kreditë tregtare të dakorduara (pagesa e shtyrë ose paradhënie) me afat më të shkurtër se një vit, kartat e kreditit të lëshuara nga rezidentët për jorezidentët, bilancet negative në llogaritë rrjedhëse të jorezidentëve dhe operacionet e blerjes së dakorduar të të arkëtueshmeve dhe marrjes së detyrimeve, regjistrohen në mënyrë të përmbledhur dhe i nënshtrohen raportimit përmbledhës.

4. Evidentimi i operacioneve kreditore me jorezidentë dhe raportimi për to kryhet për qëllime statistikore.

5. Rezidentët nga pika 2 e këtij vendimi njoftojnë drejtpërdrejtë Bankën Popullore.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, rezidenti mund t'i japë autorizim me shkrim një personi tjetër juridik për të raportuar në emër të tij për operacionet kreditore të lidhura me jorezidentë.

6. Rezidenti ose personi i autorizuar nga pika 5 (në tekstin e mëtejshëm: raportuesi) raporton individualisht ose në mënyrë të përmbledhur, në përputhje me dispozitat e këtij vendimi.

7. Raportuesi raporton individualisht për operacionet kreditore të mëposhtme:

- kredi komerciale (kredi tregtare - pagesa e shtyrë) - nëse kontrata e kredisë parashikon shitjen e mallrave ose shërbimeve midis shitësit dhe blerësit me afat pagese mbi një vit;

- kredi komerciale (kredi tregtare - paradhënie) - nëse kontrata e kredisë parashikon mbledhjen/pagesën e paradhënies për eksport/import të ardhshëm të mallrave ose shërbimeve që do të kryhet brenda një periudhe më të gjatë se një vit;

- lizingu financiar - nëse, sipas kontratës së lizingut, dhënësi i lizingut i jep në përdorim sendin e lizingut përfutuesit të lizingut, pa kalimin e pronësisë, për një periudhë të caktuar kohore dhe në kushte të caktuara;

- kredia e mallrave - nëse kreditori (institucioni financiar ose institucioni i kreditimit të eksportit) ka përcaktuar paraprakisht në kontratën e kredisë qëllimin e tij, d.m.th. ka miratuar për pagesën e mallrave ose shërbimeve në tregtinë ndërkombëtare;

- kredi financiare (hua) - nëse me kontratën kreditori i jep drejtpërdrejt hua debitorit mjete financiare (përfshirë linjat e kreditit afatshkurtër të bankës), me përjashtim të kartave të kreditit të lëshuara nga rezidentët për jorezidentët dhe bilancet negative në llogaritë rrjedhëse të jorezidentëve;

- emetimi i letrave me vlerë të borxhit në emetim të mbyllur (privat);

- kontrata e riblerjes së letrave me vlerë.

Subjekt i raportimit individual, në përputhje me këtë vendim, janë edhe kreditë afatgjata me afat maturimi pesëvjeçar e më shumë, të destinuara për krijimin e një marrëdhënie të përhershme ekonomike dhe/ose nëse jepen ndërmjet subjekteve të lidhura ekonomikisht.

8. Gjatë raportimit individual, raportuesi depoziton kërkesë në Bankën Popullore për evidentimin individual të operacioneve kreditore me jorezidentin, duke depozituar detyrimisht këto dokumente:

- kontratë kredie me shkrim e lidhur me jorezidentin;
- formularë të plotësuar në përputhje me udhëzimet e miratuara në bazë të këtij vendimi; dhe
- dokumente të tjera me kërkesë të Bankës Popullore.

9. Njoftuesi është i detyruar të njoftojë Bankën Popullore brenda dhjetë ditëve pune nga dita e lidhjes së marrëveshjes së kredisë.

Njoftuesi është i detyruar të njoftojë Bankën Popullore për të gjithë qarkullimin dhe ndryshimet në bazë të operacionit kreditues, brenda pesë ditëve pune nga dita e kryerjes së veprimit.

10. Raportuesi raporton kolektivisht për operacionet kreditore e mëposhtme:

- dorëzani dhe garanci;
- pengu i pronave të paluajtshme (hipoteka), pronave të luajtshme dhe formave të tjera të sigurimit;
- blerja e dakorduar e të arkëtueshmeve dhe marrja e detyrimeve, përkatësisht: blerja e të arkëtueshmeve nga marrëdhëniet juridike ndërmjet rezidentëve, nëse blerësi është jorezident; blerja e të arkëtueshmeve nga marrëdhëniet juridike ndërmjet jorezidentëve, nëse blerësi është rezident; marrja e detyrimeve nga marrëdhëniet juridike ndërmjet rezidentëve, nëse marrësi i detyrimeve është jorezident; marrja e detyrimeve nga marrëdhëniet juridike ndërmjet jorezidentëve, nëse marrësi i detyrimeve është rezident.

Nëse operacionet nga alineja 1 dhe 2 e kësaj pike janë pjesë përbërëse e operacionit kreditor që raportohet individualisht, ata nuk raportohen në mënyrë të përmblodhur.

Raportuesit për operacionet kreditore nga alineja 3 janë rezidentë të cilët, nëpërmjet operacioneve që përfshijnë blerjen e dakorduar të të arkëtueshmeve dhe marrjen e detyrimeve, kanë fituar detyrim ndaj jorezidentëve dhe/ose të arkëtueshme ndaj jorezidentëve.

11. Raportuesi është i detyruar të njoftojë Bankën Popullore për operacionet e përmendura në pikën 10, jo më vonë se dita e pesëmbëdhjetë e muajit për periudhën e mëparshme raportuese.

12. Guvernatori i Bankës Popullore miraton udhëzime me të cilat përshkruan formën dhe përmbajtjen e formularëve për raportim, si dhe mënyrën e plotësimit të tyre.

13. Me fillimin e zbatimit të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi për evidentimin e operacioneve kreditore jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 138/06, 57/09 dhe 146/10) dhe Vendimi për mënyrën dhe kushtet për depozitimin e raporteve për operacionet e kreditore të lidhura ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 138/06, 57/09 dhe 146/10)).

14. Ky vendim hyn në fuqi ditën e shpalljes në „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, dhe do të zbatohet nga data 1 nëntor 2015.

U nr. 02-15/XIV-1/2015
1 tetor 2015
Shkup

Guvernator
dhe kryesues i
Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov